



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SARANDË
KABINETI**

Nr _____ Prot.

Sarandë, më _____ 2018

**Lënda: Informacion për projekt-aktet e Bashkisë Sarandë për periudhën
01.01.2017-30.03.2018**

**Drejtuar: Z. Dorian Matlija
Drejtor Ekzekutiv Qendra “Res Publica”**

TIRANË

Në përgjigje të shkresës suaj Nr.85/18, datë 16.05.2018, për kërkim informacioni lidhur me projekt-aktet e hartuara nga institucioni i Bashkisë Sarandë, ju bëjmë me dije se:

1. Numri i projektakteve të nxjerra nga Bashkia Sarandë, për periudhën 01.01.2017-30.04.2018, është 4 (katër).
2. Projekt-aktet e hartuara i janë nënshtruar procedurës së njoftimit dhe konsultimit publik. Këtu veçojmë grupet e interesit, kur ka qenë fjala për Paketën Fiskale, për projektbuxhetin, për projekte që lidhen me investime të rëndësishme për territorin e Bashkisë, si: ai për rikonstruksionin e shkallareve të Sarandës, rigjenerimin urban të shetitores “N.Frashëri” etj.
3. Numri i dëgjësive publike për këto projekt-akte ka qenë 7 (shtatë). Nëpërmjet njoftimeve në median vendore, në webin dhe fb të Bashkisë, si dhe me shpallje publike, janë ftuar të bëhen pjesë e këtyre këto dëgjesa hotelierë, biznese që janë objekt i taksimit e tarifimit, qytetarë të thjeshtë që shfaqin interes për problematikën, këshilltarë bashkiakë, anëtarë të Forumit Qytetar pranë Kryetares së Bashkisë etj. E kemi të pamundur t’ju vendosim në dispozicion procesverbale të seancave dëgjimore të zhvilluara, pasi kjo nuk ka qenë praktikë pune deri tani, gjë që do të plotësohet pas kësaj kërkese, që për ne shërben edhe si vërejtje për plotësim të kësaj mangësie.
4. Numri i komenteve dhe rekomandimeve të bëra nga grupet e interesit për projekt-aktet e kësaj periudhe kohore prej 15 muajve, ka qenë i konsiderueshëm, pasi bizneset, anëtarët e Forumit Qytetar apo qytetarët e thjeshtë nuk kanë qenë thjesht dëgjues në dëgjesa, por kanë shfaqur interes për çfarë është prezantuar dhe kanë dhënë mendimin e tyre. Rekomandimet e tyre janë mbajtur shënim, sidomos nga projektuesit dhe prezantuesit e projekteve dhe, në masën 20% mesatarisht, janë reflektuar në përmirësimet që u janë bërë drafteve të paraqitura, duke u bërë pjesë e versionit përfundimtar.

Ju faleminderit për ndihmën tuaj!

KRYETAR

Florjana KOKA